



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

RrGGK Reagon Kundër Kërcënimit të Bërë ndaj Valdete Dakës

Prishtinë, 25 Shtator 2013 - Në mbledhjen e KQZ-së të mbajtur të Marten, më 24 Shtator 2013, ka ndodhur një konfrontim verbal në mes të anëtarit të Vetëvendosjes Adnan Rustemi dhe kryetares së KQZ-së, Valdete Daka.

“Veç je femër se kurrë nuk kishe guxu kështu me mu drejtu.... Kjo të jep privilegie se ndryshe ish kanë”, janë fjalët më të cilat Adnan Rustemi i Vetëvendosjes i është drejtuar kryetares së KQZ-së, Valdete Daka.

RrGGK dënon ashpër këtë kërcënim të bërë ndaj një personi publik në vend të punës. Ky kërcënim poashtu vë theksin në faktin që personi i kërcënuar është grua.

RrGGK kërkon nga Adnan Rustemi që të kërkojë falje publike lidhur me rastin.